




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, nenit 4 dhe 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, duke vendosur sipas kërkesës Nr.1-400-56603 të datës 16.11.2020 së Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së dega në Lipjan, Kryetari i Komunes, nxjerr:

VENDIM
PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 490 € (katërqind e nëntëdhjetë euro) Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së dega në Lipjan sipas kërkesës të tyre Nr.1-400-56603 të datës 16.11.2020, për ta mbështetur financiarisht për realizimin dhe mbulimin e shpenzimeve të ndryshme për shoqatën e tyre.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport në xhironlogarinë bankare të Shoqatës në nr. 1110270777000187 në ProCredit Bankë.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara, Shoqata së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së dega në Lipjan duhet të sjellë raport narrativ dhe financiar duke i bashkëngjitur faturat të cilat dorëzohen në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport më së largu deri me 30.05.2021.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Shoqata së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së dega në Lipjan.

1Nr. 400-56603
Lipjan, më 09.12.2020

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti
OPŠTINA LIPLJAN
REPUBLIKA E KOSOVËS